



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VIII

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Integrim Evropian
Mbledhja nr. 95

Prishtinë: Dt. 3. 10. 2024, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N- 303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Rrezarta Krasniqi, Fjolla Ujkani, Fridon Lala, Agon Batusha, Alban Bajrami, Shqipe Isufi, Driton Hyseni dhe Time Kadrijaj.

Munguan: Elmi Reçica dhe Blerta Deliu-Kodra.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Adelina Demolli, Ahtere Loxha dhe Safet Beqiri.

Mbledhjen e kryesoi: Rrezarta Krasniqi, kryetare e Komisionit.

Kryetarja e komisionit pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë e hapi mbledhjen.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e datës 18.9.2024;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-276 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve të veçanta për krijimin e bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga Qeveria dhe ministrat, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-283 për harmonizimin e ligjeve të veçanta me Ligjin nr. 05/L-087 për kundërvajtje, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e datës 18.9.2024

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja theksoi se qëllimi i këtij projektligji është krijimi, funksionimi, administrimi i regjistrin të pronarëve përfitues, përcaktimi i obligimeve të personave fizikë dhe subjekteve të detyruar të cilët regjistrojnë informacionin e pronësisë përfituese.

Ne si komision kemi shqyrtuar këtë projektligj dhe amendamentet e Komisionit funksional edhe më herët por sot kemi edhe këtë raport plotësues .

Ndërsa, sa i përket përafrimit me legjislacion të BE-së, njoftoi se ky projektligj nuk është në kundërshtim me legjislacion të BE-së.

Hapi diskutimin dhe e hodhi ne votim projektligjin së bashku me amendamentet e Komisionit funksional.

Pas votimit, kryetarja konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

Përfundim

Projektligji nr.08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe rekomandohet për miratim në seancë plenare.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-276 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve të veçanta për krijimin e bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga Qeveria dhe ministrat, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja tha se ky projektligj ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve të veçanta me qëllim të krijimit të bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga Qeveria dhe ministrat.

Lidhur me këtë projektligj kemi edhe amendamentet e Komisioni funksional, ndërsa, sa i përket përafrimit me legjislacion të BE-së, ky projektligj nuk është në kundërshtim me legjislacion të BE-së.

Hapi diskutimin dhe hodhi ne votim Projektligjin së bashku me amendamente.

Pas votimit, kryetarja konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

Përfundim

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve të veçanta për krijimin e bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga Qeveria dhe ministrat, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe rekomandohet për miratim në seancë plenare.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-283 për harmonizimin e ligjeve të veçanta me Ligjin nr. 05/L-087 për kundërvajtje, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja tha se ky projektligj ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Ligjeve, me qëllim të harmonizimit të tyre me Ligjin për Kundërvajtje. Lidhur me këtë projektligj kemi edhe amendamentet e komisionit funksional, ndërsa, sa i përket përafritit me legjislacion të BE-së, ju njoftoi se ky projektligj nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së.

Hapi diskutimin dhe hodhi në votim Projektligjin së bashku me amendamente.

Pas votimit, kryetarja konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

Përfundim

Projektligji nr.08/L-283 për harmonizimin e ligjeve të veçanta me Ligjin nr. 05/L-087 për kundërvajtje, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe rekomandohet për miratim në seancë plenare

6. Të ndryshme

Alban Bajrami kërkoi nga kryetarja bashkërendim të pikave të mbledhjeve të Komisionit, në rastet kur ka takime, të bashkëngjiten edhe pikat e mbledhjeve të Komisionit dhe të mbahen të njëjtën ditë, mos të vijmë të nesërmen vetëm sa për t'i votuar projektligjet.

Kryetarja, tha se dje ka pasur edhe takime tjera dhe nuk kishit pas kuorum.

Ajo njoftoi Komisionin, se në Kuvend është duke qëndruar një delegacion gjerman dhe me dt. 3 tetor ka caktuar një takim dhe të interesuarit mund të marrin pjesë.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30.

*E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit*

**Rrezarta Krasniqi,
Kryetare e Komisionit**